



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

Nr. 5410/211 Akti

Date rregj. 10.12.2019

Date vendimi 24.01.2020

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"
"PËR PUSHIMIN E CËSHTJES"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtar: LAZER SALLAKU

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Adelina Xhelili**, në Tiranë, sot më datë **24.01.2020**, pasi mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, kërkesën penale, me palë:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Erjom Imeraj**.

KALLEZUESIT:

Kuvendin e Shqiperise, përfaqësuar nga znj.Mimoza Arbi dhe z.Gamend Bici, Taulant Balla, përfaqësuesi me autorizimin me nr.4397 prot. dt.27.12.2019 leshuar nga z.Genci Gjonçaj, sekretari i pergjithshem.

Romeo Kara, i biri i Dhimiter dhe i Ilirie, dtl.15.07.1967, lindur dhe banues ne Tirane, Rr."Sulejman Delvina", pall 11/1, shk 2 ap. 7, arsimi i larte, profesioni jurist, aktualisht ekspert ligjore ne OSHEE sh.a., i martuar me tre femije, me shtetesi shqiptare, i padenuar me pare.

OBJEKTI:

Pushimin e procedimit penal nr.7340, datë 19.09.2017, për veprat penale të "Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" dhe "Pastrimit të produkteve të veprës penale", parashikuar nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE:

Neni 328/1 e 329/a i Kodit Proçedures Penale.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në praninë e prokurorit, i cili kekrej pranimin e kekrese sipas objektit.

Perfaqesuesja e Kuvendit te Shqiperise kerkoj: Ndryshe nga sa kerkon prokuroria, i kerkojme Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane kthimin e akteve per vazhdimin e hetimeve me pyetjen e dy deshmitareve Ndue Kalaj dhe Hamza Merxhani si dhe hetimin per veprat

penale te shperdorimit te detyres per ish funksionaret ne lidhje me shkeljet ligjore e nenligjore te konstatuara ne procedurat e privatizimit te OSSH- se nga CEZ a.s.

Kallezuesi Romeo Kara kerkoj: Duke qene se kerkesa e prokurorise per pushimin e kesaj ceshtjeje nuk eshte ne zbatim te ligjit, eshte e pambeshtur ne prova dhe argumenta dhe shpreh qarte se prokuroria nuk ka bere as minimumin e perpjekjeve per te zbuluar faktet dhe provat; Se prokuroria nuk ka bere nje hetim te gjithaushem duke mos respektuar jo vetem ligjin por edhe vendimin numer 240 date 15.12.2017 te kesaj gjykate; Se prokuroria ka deshtuar te binde per shkakun e pushimit te kesaj ceshtjeje; Se prokuroria nuk ka bere asnje hetim lidhur me thelbin e kesaj ceshtjeje dhe lidhjet shkak-pasoje, Une e konsideroj qe ajo nuk e ka te mbeshtetur me prova dhe fakte kerkesen e saj, se kjo kerkesa nuk duhet te merret ne konsiderate nga ana e gjykates dhe se kjo dosje duhet kthyer per plotesim hetimi.

Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe çmoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore të seancës paraprake,

VËREN:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur kërkesa me me objekt: Pushimin e procedimit penal **nr.7340, date regjistrimi 19.09.2017**, për veprat penale të **“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”** dhe **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”** nga **nenet 245/1, 287 te K.Penal.**

Gjykata në çështjen objekt gjykimi në zbatim të nenit 329/b pika 1 të K.Pr.Penale brenda pesë ditëve vendosi të caktoj seancën gjyqësore paraprake, duke njoftuar prokurorin e çështjes për ditën dhe orën e gjykimit.

Rrethanat e faktit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se, Prokuroria e Rrethit gjyqësor Tiranë, ka rregjistruar procedimin penal nr.7340, datë 19.09.2017, për veprat penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal.

Ky procedim penal është rregjistruar mbi bazë të materialit hetimor të procedimit penal nr.3, datë 14.07.2017, të rregjistruar në Prokurorinë Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, për veprat penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal.

Më datë 07.08.2017, është marrë vendimi “Për shpalljen e moskompetencës” në lidhje me këtë procedim penal, bazuar në nenet 28, pika 1 dhe 84 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale.

Procedimi penal nr.3, datë 14.07.2017, i ardhur nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është bashkim i procedimeve penale nr.3, datë 14.07.2017, për veprat penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal, rregjistruar mbi bazë të kallëzimit penal të shtetasit Romeo Kara dhe atij me numër 4, datë 17.07.2017, rregjistruar mbi bazë të raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor, të miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me anë të vendimit

nr. 36/2017 për veprat penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal.

Në vendimin e bashkimit të datës 31.07.2017, është arësytuar se të dy kallëzimet penale kanë si objekt të tyre procedurën e ndjekur nga Qeveria Shqiptare për privatizimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negociimin e Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr.10116, datë 23.04.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ-a.s-së” si dhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”.

Objekti i Komisionit Hetimor të Parlamentit, ka qenë pikërisht *“Për të hetuar dhe verifikuar zbatimin e ligjislacionit në fuqi dhe mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negociimi i marrëveshjes së shitjes së aksioneve, miratuar me ligjin nr.10116, datë 23.04.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ-a.s-së” si dhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”.*

Në vendimin e bashkimit të procedimeve penale 3 dhe 4 arësytetohet se nga ana e të dy kallëzuesve, Romeo Kara dhe Kuvendi i Shqipërisë, pretendohet se shtetasi Nue/Nuel Nik Kalaj, mbajtës i dy shtetësive, asaj shqiptare dhe kosovare, ndërmjetësuar nga shtetasi Hamza Merxhani, shtetas maqedonas, dhe banues në Pragë, për arsye të përfitimit personal, kanë ndihmuar shoqërinë CEZ group a.s për të kryer privatizimin në favor të tyre të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

Kjo pretendohet se është kryer nëpërmjet ndikimit në mënyrë të paligjshme tek personat përgjegjës të qeverisë shqiptare të kohës kur është kryer privatizimi, të cilët, duke përdorur autoritetin e tyre tek personat përgjegjës në varësi të tyre, kanë bërë të mundur që në mënyrë të nxituar dhe pa përgatitje të plotë ligjore dhe të saktë të kushteve teknike, të realizojnë privatizimin e këtij sektori të energjetikës në dëm të interesave të shtetit shqiptar dhe në favor të kompanisë ceke “CEZ group” a.s.

Nga ana e kallëzuesve ngrihet pretendimi se në periudhën janar 2008 deri në qershor të vitit 2009 kompania “CEZ group” a.s. nëpërmejt një banke të nivelit të dytë ka kryer transksione parash në favor të shtetasit Nue Kalaj shuma prej 6.854.248 (gjashtëmilionë e tetëqind e pesëdhjetë e katërmijë e dyqind e dyzetë e tetë) euro, në datën 12.06.2009, pa dokumentacion justifikues nga banka. Kjo shumë nuk justifikon shërbimin e pretenduar të kryer për CEZ në lidhje me informacione të nevojshme të kësaj të fundit në territorin shqiptar.

Nga viti 2012 deri në vitin 2013, Kalaj është bërë aksioner në masën 49% në kompaninë “ANTIKA 04”sh.p.k, e cila ka ndryshuar emrin në HAM Group me nr. Nipti K41512019J, kompani e cila ka lidhur me CEZ sh.a katër kontrata furnizimi për një periudhë 12-mujore.

Sipas kallëzimeve rezulton se ky shtetas ka pasur njohje dhe kontakte me ish-ministrin e METE, ish/kryeministrin e asaj kohe si dhe me të birin e këtij të fundit.

Në vendimin e saj të bashkimit të procedimeve, Prokuroria e Përgjithshme arësytetohet pretendimet e mësipërme kanë në fokus të tyre privatizimin e kryer në mënyrë të kundërligjshme, duke shkëlur kuadrin ligjor dhe për më tepër, ka qenë i paracaktuar, c’ka nënkupton një procedurë fiktive.

Kallëzimet penale të kryera nga shtetasi Romeo Kara dhe Kuvendi i Shqipërisë kanë si objekt të tyre, procedurën e privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr.10116, datë 23/04/2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ-a.s-së” si dhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”.

Me vendimin nr. 30, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar më datë 14.04.2016, ngritjen e Komisionit Hetimor me objekt:

“Për të hetuar dhe verifikuar zbatimin e ligjislacionit në fuqi dhe mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i marrëveshjes së shitjes së aksioneve, miratuar me ligjin nr.10116, datë 23.04.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ-a.s-së” si dhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”.

Puna e komisionit rregullohet mbi bazë të ligjit 8891, datë 02/05/2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Parlamentare.” Objekti i punës së këtij komisioni hetimor, lidhet me një çështje të vecantë dhe konkrete, sipas parashikimeve të nenit 3 të këtij ligji, dhe nenit 77, pika 2 të Kushtetutës dhe është mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar.

Objekt material të tij ka procedurën e privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. **Objekti i tij i punës nuk përmban zyrtarë me imunitet.**

Në raportin e Kuvendit të Shqipërisë, miratur me anë të vendimit nr. 36/2017, në mënyrë të përmbledhur pretendohet se nga ana e zyrtarëve të lartë të kohës është ushtruar ndikim kanë pasur synim dhe realizuar ardhjen e pasojave të kundërligjshme si:

Është nxjerrë në privatizim një shoqëri e sapo krijuar, e cila ka pasur rëndësi strategjike për interes e vendit dhe që nuk kishte kryer asnjë bilanc energjetik dhe nuk kishte eksperiencë për të operuar në tregun e energjisë, nuk kishte asete të përcaktuara, duke paraqitur OSSH si funksionale, me qëllim oprivatizimin më shpejtësi në favor të CEZ.

Janë ndryshuar tregues specifikë në deklaratat rregullatore duke ushtruar ndikim të paligjshëm dhe imponuar ERE-n në vendimarrje të kundraligjshme.

Është kualifikuar dhe shpallur fitues oferuesi CEZ në shkelje të hapur të kushteve minimale të performancës teknike në shkelje të VKM-së nr. 835, datë 11/06/2008.

Eshtë negociuar me CEZ për nivelin e borxhit të keq, që do të pranohej në llogaritjen e të ardhurave të kërkuara nga kompania në kundërshtim e në kapërcim të kushteve të procedurës konkurruese të përcaktuar më parë.

Me anë të negociimit për treguesin e humbjeve totale, si tregues i kushteve minimale të performancës teknike i panegociueshëm.

Duke pranuar, gjatë negociimeve të kryera, te gjitha kërkesat e ofertuesit, të bëra gjatë paraqitjes së ofertës teknike nga mosnjohja e situates, si pasojë e mosfunksionimit real të OSSH-së dhe mosqenies së saj e gatshme për privatizim.

Mosvazhdimi i procesit të rivlerësimit të cmimit të shitjes sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në nenin 3.3 të MSA datë 11/03/2009.

Favorizimin e vazhdueshëm e të kundërligjshëm të CEZ, ndodhur kjo para, gjatë dhe pas procesit të privatizimit të OSSH-së.

Në kallëzimin e shtetasit Romeo Kara në mënyrë të përmbledhur pretendohet se:

Privatizimi i OSSH-së është quajtur i nxituar, bazuar në qëndrimet shprehura nga ana e znj.Kseniya Lvosky drejtoreshë e Bankës Botërore për Shqipërinë dhe ish zv -Ministri i Ministrisë së Integritit të kohës Albert Gajo. E para e ka quajtur të nxituar, pavarësisht se kishte miratimin e Bankës Botërore, ndërsa i dyti ka përcjellë edhe mendimin e specialistëve të Komisionit European, të cilët kishin ngritur shqetësimin se shoqëria ka bilanc negative dhe është me humbje dhe si e tillë, duhet të likujdohej dhe jo të privatizohej.

Pamjaftueshmëria e legjislacionit për të kryer një privatizim të këtij lloji, e cila passolli një sërë negociimesh, duke zhvlerësuar kërkesat teknike dhe ekonomike, të parashikuara në dokumentet e tenderit. Sipas tij, objekt i privatizimit, duhet të ishte shërbimi dhe jo asetet e OSSH-së.

Sipas tij, nga ana e komisionit negociator, u rrëzuan pa pasur këto attribute, kushtet minimale për të marrë pjesë në procedurë dhe për me tepër, këto kushte, ishin vendosur në VKM-të nr. 487, datë 16.04.2008 “Për kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sha dhe asaj me numër 835, datë 11.06.2008 “Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit, të shoqërisë anonime “Operatori i sistemit të shpërndarjes”, që u ofrohet investitorëve startegjikë”.

Procesi i privatizimit është kryer duke mos zgjidhur problemin e titujve të pronësisë mes OSSH-së dhe KESH, ku edhe aktualisht ekziston problemantikë, e cila lidhet me faktin se ende një pjesë e titujve i përkasin kësaj të fundit. Pavarësisht miratimit të VKM-së nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të OSSH-së sh.a”, kjo e fundit ka dalë në një moment jooportun dhe pak javë para hapjes së ofertave dhe ka lënë pas një sërë konfliktesh .

Edhe pas hapjes së procedurës së tenderimit nuk ishte kryer një demarkacion mes detyrimeve të KESH dhe OSSH-së. Sipas tij, urdhëri nr. 500, datë 01.07.2008, i ministrit të kohës Genc Ruli, për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet KESH dhe OSSH-së, është përdorur disa herë nga drejtuesit cekë të CEZ në procese kundër qeverisë shqiptare si një provë në favor të interesave të tyre për të përlligjur mospërmbushjen e detyrimeve.

Ndryshimi i modelit të tregut të energjisë elektrike, përgjatë zhvillimit të procesit të privatizimit, pa testuar modelin e ri të tregut dhe pa vënë në dijeni ERE-n, në lidhje me detajet e procesit të privatizimit dhe duke ndryshuar brenda një kohe të shkurtër, katër here, deklaratën rregullatore të ERE-s, në varësi të zhvillimeve të procesit të privatizimit.

Shkeljet e procedurave të procesit të privatizimit, duke mos mbajtur paketë aksionesh ose aksionin e artë, sipas nenit 110 të ligjit nr. 8306, datë 14/03/1998 “Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të vecantë”, i ndryshuar, duke miratuar VKM-në nr. 835 datë 11.06.2008, paketën 76% aksionesh të investitorët strategjikë, pa marrë parasysh interesat e shtetit shqiptar, duke mos ngelur aksioner në asnjë masë, sado të vogël dhe minimale aksionesh, 1 apo 2 %.

Eshtë shkelur afati minimal tre mujor për zbatimin e kësaj procedure, sipas nenit 11, të ligjit 8306, datë 14.03.1998.

Nuk iu është ofruar pjesa e mbetur e aksioneve subjekteve të përcaktuara në nenin 3 të ligjit 9889, datë 20.03.2008 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i sistemit të shpërndarjes” .

Nuk janë përdorur të ardhurat e privatizimit, sipas parashikimeve të nenit 5 të ligjit 9889, datë 20.03.2008 duke qenë se ndërkohë është miratuar një VKM për shpërblimin e komisioneve pjesëmarrëse në privatizim dhe shoqërisë konsulente.

Nuk është vendosur një cmim dysHEME në procedurën e privatizimit sipas nenit 8 të ligjit nr. 9889, datë 20.03.2008 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i sistemit të shpërndarjes””. Këshilli i Ministrave ka përcaktuar një klauzolë në dokumentet e tenderit me titull “Purchase price adjustment”, sipas të cilës CEZ dhe komisionet të efektojnë të gjithë procesin duke rishikuar cmimin e blerjes në mënyrë të pakufizuar në dëm të interesave të shtetit shqiptar.

Miratimi i borxhit të keq nga 4% deri në 14%, ka favorizuar kompaninë CEZ, pasi ky ndryshim përllogarit një dëm në buxhetit e shtetit në vlerën e shtatëdhjetë milionë lekëve.

Interesave të shtetit shqiptar, sipas tij, i është shkaktuar një dëm si pasojë e rritjes së vlerës së asetëve e cila uli cmimin e blerjes së OSSH-së në vlerën 55 milionë euro, sipas vkm 218, datë 06.03.2009, një javë para firmosjes së marrëveshjes për blerjen e aksioneve.

Sipas tij në këtë procedurë janë vërejtur një sërë shkeljes së ligjit “Për prokurimin publik” e më konkretisht:

Të nenit 42, pika 3, në lidhje me mbajtjen e protokollit të procedurës,

Të nenit 43, pika 2, të po këtij ligji për afatet kohore të dorëzimit të ofertave.

Ngritja dhe përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e OSSH-së me urdhërin nr. 329, datë 13.05.2008 në kundërshtim me pikën 1, kreu VII të VKM-së nr.329, datë 12.07.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjike dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregëtare të sektorëve me rëndësi të vecantë”, si dhe pikën 3 të VKM-së nr. 621 datë 25.09.1998 “Për krijimin e komisioneve të konsulencës dhe të transparencës për privatizimin e sektorëve me rëndësi të vecantë të ekonomisë” etj.

Gjithashtu, ai ngre pretendimin se garancia e ofertës në vlerën pesë milionë euro, e vendosur me anë të VKM-së 1170, datë 13.08.2008 është favorizuesë për CEZ, pasi në të vërtetë duhet të jetë në masën 20% të vlerës së aksioneve, e përcaktuar si e tillë edhe sipas urdhërit 319, datë 06.05.2008 të ministrit Genc Ruli “Për zmadhimin e kapitalit të OSSH-së” dhe pikës IV të VKM-së 329 datë 12.07.1999.

Në kallëzim ngrihet pretendimi se është shkelur kuadri nënligjor një sërë VKM-sh në lidhje me personat anëtarë komisionesh.

Kështu ai pretendon se VKM-ja nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, në pika 1/a dhe 2/ç bashkon kompetencat e personave që hartojnë dokumentet e tenderit për parakualifikim si dhe atyre që i vlerësojnë ato, duke vënë gjithashtu edhe në pozitën e konfliktit të interesit ministrin e METE Genc Ruli, i cili duke qenë njëkohësisht ministër dhe kryetar i Komisionit të Konsulencës dhe Transparencës krijonte handicap, pasi në pozita të tilla, do t’i duhej të nxirrte urdhër ndaj personit të tij.

Në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal është marrë me anë të procesvebralit të datës 05.07.2017, në mbështetje të neneve 93 etj të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i pushimit të procedimit penal nr.1, datë 11.02.2017 i Prokurorisë së Përgjithshme.

Objekt i këtij hetimi, ka qenë materiali kallëzues i depozituar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI). Kjo prokurori, ka regjistruar procedimin penal nr.1 viti 2016, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal.

Sipas këtij vendimi rezulton se *“Ministria e Energjitikës dhe Industrisë (MEI), kallëzimin e saj e ka mbështetur në të dhënat e raportit të Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, i kryer lidhur me rregullshmërinë e procesit të privatizimit të shoqërisë OSSH sha, nënshkrimin të marrëveshjes për shitjen e 76% të aksioneve të kësaj shoqërie (MSA) dhe zbatimit të kësaj marrëveshje. Nga të dhënat e raportit të Auditit të Brendshëm, kanë rezultuar fakte dhe rrethana të paligjshme të cilat krijojnë dyshimin se përbëjnë elementë të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i K.Penal, të kryera nga funksionarë publik, të cilët me veprimet e mosveprimet e tyre, kanë favorizuar hapur ofertuesin e shpallur fitues “CEZ as”. Gjithashtu në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, kanë vijuar me favorizime edhe në etapat e tjera gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, duke i sjellë shoqërisë CEZ Shpërndarje përfitime materiale të padrejta, të cilat kanë dëmtonuar rëndë interesat e ligjshme të shtetit shqiptar dhe të personave të tjerë juridikë.”*

Kallëzimi penal është ngritur kundër shtetasve Genci Ruli, me detyrë ish Ministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, aktualisht deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Neritan Alibali, me detyrë ish Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, Enno Bozdo, me detyrë ish Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, Florjon Mima me detyrë ish Ministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, aktualisht deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Ridvan Bode me detyrë ish Ministër i Financave, aktualisht deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Suzana Guxholli, ish Këshilltare pranë ish Kryeministrit, etj.

Në përfundim të hetimit të këtij procedimin penal, prokuroria ka vendosur më datë 13.07.2016 pushimin e hetimeve bazuar në nenin 328 pika “1”, gërma “b” të Kodit të Procedurës Penale, duke arësytuar se:

“.....nga gjithë hetimet e kryera, sikurse janë, aktet e paraqitura në kallëzimin e MEI, aktet e marra dhe të administruara me vendim qyrrje dhe marrje gjatë hetimit paraprak, dëshmitë të personave që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe të gjitha veprimeve të tjera hetimore, ka rezultuar se gjendemi para një procedure prokurimi të kryer në përputhje me ligjin, akteve nënligjore në fuqi dhe të një procedurë të miratuar nga organet kompetente për privatizimin e shoqërisë OSSH sh.a. ku në përfundim është nënshkruar marrëveshja për blerjen e aksioneve të firmosur më datë 11.03.2009 dhe miratuar përfundimisht nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, me ligjin nr. 10116, datë 23.04.2009, botuar në fletoren zyrtare nr. 60 datë 14.05.2009.....

Zhvillimi i procesit për privatizimin e shoqërisë OSSH sh.a, rezulton se është tërësisht i bazuar në Kushtetutë dhe aktet ligjore e nënligjore....”

....Në përfundim dhe si konkluzion, nga hetimet e kryera në kuadër të këtij procedimi penal rezulton se faktet e provuara nga hetimi dhe të përshkruar më sipër në këtë vendim, nuk parashikohen nga ligji si vepër penale e “Shpërdorimit të detyrës”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal.

Gjithashtu fakti i provuar nga hetimi nuk parashikohet nga ligji, as si ndonjë vepër tjetër penale e parashikuar në Kodin Penal.”

Në lidhje me këtë vendim, është ushtruar ankim pranë Gjykatës së Lartë nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Gjykata e Lartë, me anë të vendimit të saj të datës 21.11.2016, ka arësytuar se **“Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e gjen të drejtë vendimin Prokurorisë së Përgjithshme për Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.1 të vitit 2016, regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal, si një vendim të dhënë në zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural penal. Ky vendimi është rrjedhojë e kuptimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit penal dhe, si i tillë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se ai do të lihet në fuqi.”**

Gjykata e Lartë, në përfundim, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga MEI, me objekt “Kundërshtimin e vendimit datë 13.07.2016 për pushimin e procedimit penal nr.1, të vitit 2016 të Prokurorisë së Përgjithshme.”

Në këto rrethana, prokuroria ka arritur në konkluzionin se:

Sa më sipër, jemi në kushtet e parimit të “gjësë së gjykuar”...

...Në këto kushte, themi se e gjithë procedura e ndërmarrë për privatizimin e OSSH-së është konsideruar si e bazuar tërësisht në kushtetutë dhe bazën ligjore.

Sic është theksuar edhe më lart, procedimi penal nr.7340, është filluar për veprat penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal. Neni 245/1 I Kodit Penal parashikon se:

“Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtim ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.”

Në të dy kallëzimet e paraqitura, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe ai i shtetasit Romeo Kara, ngrihen pretendime për konsumim të elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga ana e këtij neni.

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm, sipas kallëzuesit Romeo Kara, i shprehur edhe në deklaratimet e tij të datës 13.06.2017 konsiston ndaj shtetasve Nue Kalaj, Genc Ruli, Sali Berisha dhe Zana Guxholli, duke arësytuar se ndikimi është realizuar nga ana e Kalajt për shkak të lidhjeve që kishte ky fundit me CEZ Group në Pragë dhe ish-Kryeministrin e asaj kohe, Sali Berisha.

Këto fakte ky shtetas i bazon në përmbajtjen e-maileve të shkëmbyera, kryesisht, me palë Nuel Kalajn.

Kështu në emailin e datës 07/09/2009, ora 13:51 pm, nga adresa e email nuelkalaj@gmail.com, dërguar Martin Roman, në atë kohë drejtor i CEZ Group Pragë, në paragrafin e pestë thuhet se “...duke folur sinqerisht, mua personalisht më vjen shumë keq të shoh pas një pune katër vjecarë për CEZ-in, duke luftuar që një kompani serioze dhe e sukseshme si CEZ-I të futet në sektorin energjetik në Shqipëri, probleme të ngjashme të shkatërrojnë frutin e një pune të madhe që unë dhe zoti Petran kemi bërë për muaj dhe negociime pas negociimesh për të arritur një privatizim të suksesshëm të OSSH-së....: në paragrafin e gjishtë thuhet se...”jam informuar se CEZ Albania ka marrë një hua nga CEZ për të arritur një marrëveshje për debt collection. Unë kam qenë gjithnjë i hapur dhe i gatshëm për të bashkëpunuar me drejtuesit e CEZ-Albania dhe besoj se është mundësia në terren për të punuar në mënyra të ndryshme pa qenë e nevojshme për të marrë hua një shumë të tillë.

Emal-i i dates 11/05/2010, ora 09:10 me dërgues Nuel Kalaj, drejtuar Tomas Plesksh, zv/drejtor i CEZ Group me subject “Kosova”, ai është prononcuar ..paraprakisht ju kam informuar se marrëveshja me ERE do të jetë nënshkruar shumë shpejt, sidoqoftë në këtë moment qeveria e Shqipërisë po negocion për të marrë hua, dhe problem.”

Në përmbajtje të email-it të datës 15/05/2010 ora 12:05, dërguar Jozef Hejsek, Nue Kalaj në pikën gjashtë shprehet: “Z. Hejsek nuk e ka kuptuar se unë nuk mund të bashkëpunoj me njerëz, të cilët janë tërësisht të implikuar në korrupsion dhe japin informacione të rreme në lidhje me situatën....unë do ta coj deri në fund atë çfarë kam nisur. Unë do të informoj drejtorin e Përgjithshëm të CEZ, Z. Martin Roman, Kryeministrin e Shqipërisë si dhe palët e interesuara ...mos u surprizoni zoti Hejsek nëse nesër ju shpallen person non grata në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fillimisht unë do t'i dërgoj një raport Z. Merxhani. Pasi zoti Merxhani të jetë informuar për situatën do të komunikohet me z. Hejsek, Martin Roman dhe institucionet shqiptare. Në këtë raport janë vetëm një pjesë e vogël e situates, sepse nëse do të fillojmë një investigim, ai do të trondisë si tërmet kompaninë.”

Në emailin e datës 28/01/2010, ora 12:40 që Josef Hejsek i ka dërguar Tomas Pleskash, thuhet ndër të tjera: “Me Nuelin sapo mbarova negociatat e tjera, i shpjegova në detaje se çfarë kërkojmë. Takimi me të birin, sipas Nuelit është shtyrë për nesër pas ardhjes së PM (duke nënkuptuar kryeministrin). Mbrëmë kam shtrënguar duart me kryeministrin në takimin me investitorët. Ai tha se është shumë i kënaqur që do të të takojë nesër. Çfarë duhet të presim nga kryeministri. Sipas Nuelit rezultatet në mënyrë të sigurtë do të jenë pozitive dhe në 90% konkrete. Ai më siguroi se për kryeministrin punon një komision ndërministror, i cili në mënyrë të specializuar po trajton problematikën tonë. (mund t'ju konfirmoj që kam folur me disa anëtarë të komisionit që po merren me këtë marrëveshje).

Në e-mailin e datë 17/11/2011, ora 03:37 që Josef Hejsek i ka dërguar Nuel Kalajt, me subject “Banka Botërore”-njoftim i ngjarjes thuhet: Këtë mbrëmje kemi qenë këshilluar se sot është dita e duhur për të dorëzuar njoftimin tonë për rastin e garancisë së pjesshme të rriskut duke reflektuar vendimin e ERE-s lidhur me studimin e borxhit të keq të Deloitte’s”.

Sipas Raportit Përfundimtar të Komisionit Parlamentar Hetimor dhe dokumentacionit bashkëlidhur, shtetasi Romeo Kara ka deklaruar të njëjtat fakte dhe dorëzuar të njëjtin dokumentacion, si ai bashkëlidhur kallëzimit në prokurori.

...Në lidhje me ushtrimin e ndikimit të paligjshëm, në raport, Kuvendi i Shqipërisë del në përfundimin se persona me autoritet kanë vijuar me dhënien e miratimeve dhe kanë

ushtruar ndikim të paligjshëm për një vendimarrje që nuk i takonte institucionit të tyre, por ERE, si një institucion i pavarur, kanë hyrë në proces për zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes të lindura mes kompanive CEZ në dëm të një shoqërie publike sic është KESH.

Kallëzimi penal për veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm nga ana e Kuvendit është kryer ndaj shtetasve Sali Berisha, Nuel Kalaj, Genc Ruli, Ridvan Bode dhe Shkëlzen Berisha.

Duke analizuar informacionin e ndodhur në fashikullin hetimor, aktet e hetimit paraprak që ndodhen në dosje organi i prokurorise ka arritur ne konkluzionin se:

Vepra penale e “Ushtrimit të ndikimit”, parashikuar nga nenei 245/1 i Kodit Penal, në rastin konkret lidhet ngushtësisht me procesin e privatizimit të OSSH-së. Duke ju përmbajtur dispozitës, neni 245/1, pikë së pari, duhet të ekzistojë premtimi, propozimi ose dhënia drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë i cfarëdo **përfitimi të parregullt për vetë ose persona të tjerë...**Referuar akteve të hetimit paraprak, është konkluduar se nuk provohet të jetë dhënë një përfitim i tillë i cfarëdolloji. Përfitimi në këtë rast nënkupton një lidhje të drejtpërdrejtë me vendimarrjen. Vendimarrja në rastin konkret ka si produkt të saj procedurën e privatizimit të OSSH-së.

Sic u tha edhe më lart, kjo procedurë e zhvilluar lidhur edhe me pretendimevet e palëve të listuara më sipër, ka qenë objekt i një hetimi në kuadër të procedimit penal nr.1/2016, i cili e ka konsideruar atë të kryer konform ligjeve dhe kushtetutës. Në këtë procedim penal është marrë në shqyrtim e gjithë procedura e zhvilluar. Sic u tha edhe më sipër, Gjykata e Lartë ka rrëzuar ankimin e ngritur nga ana e kallëzuesit Ministrisë së Energjetikës.

Në kallëzimet penal, është pretenduar se ndikimi është kryer nga ana e shtetasit Nue Kalaj, i cili rezulton të kishte njohje me shtetasin Shkëlzen Berisha dhe ka përmendur në një e-mail dhe kryeminitrin e asaj kohe, zotin Sali Berisha. Në përmbajtjet e e-maile-ve pavarësisht, se shihet interesimi i shtetasit Nue Kalaj në lidhje me procedurën e privatizimit dhe hidhet dritë mbi faktin se ai kishte kohë që punonte pranë kompanisë CEZ, me focus të punës së tij kishte përhapjen e saj në tregun shqiptar, nuk përmend në asnjë rast dhe nuk rezulton të ketë ushtruar ndikim në asnjë lloj forme, qoftë edhe të nënkuptuar dhe as rezulton të ketë kërkuar përfitime të paligjshme për të premtuar kryerjen këtij ndikimi.

Nga përmbajtja e e-maileve, jepen informacione në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes dhe në tërësi objektin e saj, si në lidhje me borxhin, huatë, nënshkrimin e marrëveshjes etj.

Në përmbajtjen e tyre ai flet për probabilitet në kryerjen e veprimeve nga ana e qeverisë shqiptare, por në asnjë rast nuk flitet për premtime konkrete, realizim “negociatash” ose e thënë ndryshe, bisedimesh mes tij dhe personave që kryejnë ndikim dhe marrim përsipër kryerje të ndikimit.

Në njërin nga e-mail-et thuhet se ka shtrënguar duart më kryeministrin dhe se ai është i kënaqur të presë shtetasin Tomas Pleskash.Ky takim sic del është kryer në një takim me investitorët. Ky pohim nuk shoqërohet me asnjë të dhënë tjetër që të nënkuptojë se tek ai është ushtruar ndikim për të kryer një gjë të tillë. Nga përmbajtja e e-mail-it rezulton se takimi me të birin do të kryhej një ditë më pas, c’ka nënkupton se në momentin që kryeministri ka shfaqur kënaqësinë për takimin, takimi me këtyre personave nuk ishte realizuar.Nga ana e kallëzuesve ngrihet pretendimi se në periudhën janar 2008 deri në qershor të vitit 2009, kompania “CEZ group” a.s. nëpërmejt një banke të nivelit të dytë,

ka kryer transksione parash në favor të shtetasit Nue Kalaj shuma prej 6.854.248 (gjashtëmilionëetëqindpesëdhjetëkatërmijëedyqindedyzetëetë) euro, në datë 12/06/2009, pa dokumentacion justifikues nga banka.

Shuma e mësipërme, nuk mund të konsiderohet si përfitim në kuadër të arësytimit të mësipërm, pasi nuk rezulton që nga kjo shumë të jetë kryer ndonjë transaksion i mëtejshëm në favor të ndonjë përfituesi i cili mund të kryejë ndikim.

Nëse i referohemi, kohës në të cilën është bërë kalimi i shumës dhe në tërësi, periudhës gjatë së cilës janë kryer transfertat, del se transfertat e fundit mban datën 12/06/2009, ndërsa emailt e tjera, ku përmendet takimi me të birin, duke nënkuptuar kryeministrin dhe lidhjen e tij me shtetasin Shkëlzen Berisha, janë kryer kohë më vonë, në vitet 2010 e në vijim.

Në vijim të përmbajtjes së dispozitës nr. 245/1 të Kodit Penal, analizohet se elementët e anës objektive janë propozimi, premtimi apo dhënia...e përfitimit të paligjshëm personit që premtim ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm...(sipas paragrafit të parë) dhe kërkimi, marrja ose pranimi ... i përfitimit të parregullt ...duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës...(sipas paragrafit të dytë).

Nga përmbajtja e e-mail-eve nuk rezulton të jetë premtuar ndikimi tek ndonjë person konkret në një mënyrë konkrete. Në e-mail-in e datës 07/09/2009, ora 13:51 pm, Nuel Kalaj ofron shërbimin për të bashkëpunuar me drejtuesit e CEZ Albania për të shmangur marrjen e një borxhi kompanisë CEZ. Pra sic shihet, në këtë rast është ofruar ndihmë në kuadër të shoqërive, pa përmendur asnjë institucion shtetëror apo person që ushtron funksion publik.

Në emailin e datës 11.05.2010, ora 10:00 me dërgues Nuel Kalaj, drejtuar Tomas Plesksh, zv/drejtor i CEZ Group, me subject "Kosova", informon në lidhje me faktin se qeveria shqiptare po përgatitet për të marrë një hua dhe e konsideron këtë si një problem. Ky fakt qëndron në kuadër të një informacioni.

Në e-mail-in e datës 15.05.2010 ora 12:05, dërguar Jozef Hejsek, Nue Kalaj shprehet se do të vërë në dijeni zotin Martin Roman dhe vetë kryeministrin në lidhje me situatën. Ai përmend Merxhanin dhe drejtues të tjerë dhe shprehet se ai mund të shpallet person non gratta nga qeveria shqiptare. Përmend, gjithashtu, edhe faktin, se nëse kryhet investigim, mund të tronditen nga themelet kompania. Nga përmbajtja e këtij e-mail-i nënkuptohet parregullsi në punën e Hejsek, të cilat Kalaj i cmon si të tilla që mund ta bëjnë atë person të padëshiruar në territorin shqiptar, duke përmendur dhe pasoja për shoqërinë CEZ, të cilat kanë rrejdhojë pikërisht punën e Hejsekut. Në këtë e-mail Kalaj deklaroi se nuk merret me persona të përfshirë në korrupsion dhe japin informacione të rreme në lidhje me situatën. Kjo hedh dyshime se persona të tillë, janë Hejsek dhe të tjerë të paidentifikuar.

Në e-mail-in e datë 17.11.2011, ora 03:37 është Josef Hejsek ai që informon Kalajn se kanë qenë këshilluar se sot është dita e duhur për të dorëzuar njoftimin për rastin e garancisë së pjesshme të riskut duke reflektuar vendimin e ERE-s, lidhur me studimin e borxhit të keq të Deloitte.

Ne perfundim te hetimeve Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me kerkesen per pushimin e procedimit penal duke mos konstatuar elementet e vepres penale te dyshuar.

Sa më sipër, pasi nga hetimi i zhvilluar dhe nga vetë arësyetimi i ndjekur, nuk ka rezultuar që të provohen elementët e figurës së veprës penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 245/1 I Kodit Penal nga ana e shtetasve të kallëzuar. Nuk provohet, se nga ana e tyre të jenë konsumuar elementët e kësaj figure vepre penale, duke bërë të mundur vërtetimin e rrethanave dhe fakteve të cilat do të krijojnë një lidhje mes elementëve të anës objektive dhe asaj subjektive, sic kërkohen nga neni 245/1 i këtij Kodi.

Hetimi në lidhje me këtë procedim penal, ka nisur edhe për figurën e veprës penale të “Pastrimit të parave”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Duke qënë së hetohet për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, primare në vijimin e hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, është fakti nëse burimet e të ardhurave janë të paligjshme. E thënë ndryshe, të jenë përvijuar nga një veprimtari e paligjshme dhe kriminale. Ky arsyetim lidhet ngushtë me përmbajtjen dhe vullnetin e nenit 287 të Kodit Penal, i cili kërkon si elementë të anës objektive të tij kryerjen e një sërë veprimesh të llojit “këmbim, transferim i pasurisë, fshehje, mbulim, përdorim, investim në veprimtari kriminale...., etj të pasurive që dihet se janë produkt i veprës penale. E interpretuar më gjërë, do të ishim para kushteve të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, nëse nga ana e shtetasit do të ishte kryer një vepër penale, nga e cila gjenerojnë pasuri apo të ardhura të tjera. Gjithashtu, personi do të ishte përgjegjës edhe në rastin e tjetërsimit të të ardhurave të të tjerëve, familjarëve të tij.

Nga hetimi nuk rezultoi të jenë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Kjo është një vepër penale që ka si objekt material të saj përfitimin e parregullt të cfarëdolloji, qoftë përfshirë edhe atë material dhe si e tillë, në rast se do të ekzistonte ky fakt, do të krijohej dyshimi se nga vepra penale janë gjeneruar të ardhura të paligjshme dhe do të ishim në kushtet e nenit 287.

Nga ana e Gjyqesës së Rrethit Gjyqësor Tirane, me vendim nr. 240 akti date 15.12.2017, pas kërkesës së organit të prokurorisë për pushimin e çështjes, është vendosur kthimi i akteve prokurorit dhe vazhdimi i hetimeve të procedimit penal nr. 7340 date 19.09.2017, duke lënë edhe detyra në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal

Nga ana e organit të prokurorisë janë kryer veprimet e mëposhtme:

Eshtë pyetur në cilesinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qellimet e hetimit shtetasi Shkelzen Berisha.

Eshtë pyetur në cilesinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qellimet e hetimit shtetasi Genc Ruli.

Eshtë pyetur në cilesinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qellimet e hetimit shtetasi Hasan Amataj.

Eshtë pyetur në cilesinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qellimet e hetimit shtetasja Albana Troçe, ish drejtoreshë e degës së Raiffeisen Bank, rruga e Kavajës

Eshtë pyetur në cilesinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qellimet e hetimit shtetasja Rudina Rudi, drejtoreshë e degës së Raiffeisen Bank, rruga e Kavajës

Eshte administruar prane Prokurorise se Pergjithshme dosja qe i perket vendimit date 13.07.2016 per pushimin e procedimit nr.1 date 11.02.2016 te Prokurorise se Pergjithshme, lene ne fuqi nga Gjykata e Larte.

Jane administruar te dhenat mbi transaksionet bankare te shtetasit Nue Kalaj.

Ne kushtet kur nuk eshte bere e mundur gjetja e shtetasit Nue Kalaj, eshte derguar leterporosi ne Republiken e Kosoves me qellim pyetjen e shtetasi Nue Kalaj si dhe administrimin e disa te dhenave te tjera me interes per hetimin.

Eshte derguar leterporosi ne Republiken e Cekise me qellim pyetjen e shtetasit Hamza Merxhani, pyetjen e administratoreve te CEZ s.a, administrimin e kontratave te lidhura mes administratoreve te CEZ s.a dhe shtetasit Nue Kalaj dhe administrimin e akteve te tjera me interes per hetimin.

Nga ana e autoriteve kosovare te drejtesise eshte percjelle materiali ne ekzekutim te leterporosise, material i derguar ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me shkrese nr. 1804/3 prot./B K date 19.09.2018, nga Ministria e Drejtesise. Rezulton se nga ana e autoriteteve kosovare jane kryer veprimet hetimore te kerkuara me perjashtim te pyetjes se shtetasit Nue Kalaj i cili rezulton te mos jete gjetur nga kerkimet e kryera nga keto autoritete.

Jane percjelle bashkelidhur nga autoritetet kosovare informacion per shtetasin Bege Rizai, te dhenat personale te shtetasit Nue Kalaj, dokumentacioni me te dhenat nga ARBK per bizneset e shtetasit Nue Kalaj, informacion lidhur me hyrje daljet nga Republika e Kosoves te personit Nue Kalaj, te dhena financiare te shtetasit Nue Kalaj.

Nga ana e autoriteteve çeke te drejtesise eshte percjelle materiali ne ekzekutim te leterporosise, material i derguar ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me shkrese nr. 3837/1 prot. AH date 01.11.2018, nga Ministria e Drejtesise. Me shkrese nr. 3837/1 prot. AH date 06.12.2018 nga Ministria e Drejtesise eshte percjelle edhe perkthimi ne gjuhen shqipe i akteve te leterporosise.

Rezulton se nga ana e autoriteteve çeke te drejtesise eshte bere e mundur marrja ne pyetje e shtetasit Tomas Pleskac i cili nder te tjera deklaroi se nuk ka marre pjese ne procesin e privatizimit te OSSH dhe se nuk mund t'i pergjigjet pyetjes lidhur me kontaktet apo ndermjetesit ne kete proces. Lidhur me pagesen prej 6.854.248 euro transferuar shtetasit Nue Kalaj, deklaroi se CEZ kryen miliona pagesa ne vit dhe eshte e qarte qe gjate transaksioneve ne shuma te tilla merren keshilla te ndryshme ligjore, teknike, ekonomike etj dhe gjithashtu paguhen shperblime per sherbime te tilla.

Eshte bere e mundur pyetja e shtetasit Josef Hejsek i cili nder te tjera ka deklaruar se nuk ka qene i perfshire ne procesin e privatizimit te OSSH dhe nuk ka qene ne kontakt me shtetas te huaj apo shtetas shqiptare si ndermjetes ne procesin e privatizimit te OSSH. E njej shtetasin Nue Kalaj. Pas nenshkrimit te kontrates pra pas privatizimit ka qene ne kontakt me persona te ndryshem perfshi edhe qeveritare vendas. Nuk i kujtohen emrat por kane qene perfaqesues te qeverise dhe nepunes te ndryshem. Lidhur me pagesen prej 6.854.248 euro transferuar shtetasit Nue Kalaj deklaroi se nuk eshte ne dijeni per te. Lidhur me permbajtjen e nje emaili te dates 28.1.2010 deklaroi se nuk i kujtohet nje email i tille.

Nga autoritet çeke nuk eshte bere e mundur pyetja e shtetasit Martin Roman pasi ky shtetas rezulton se eshte larguar nga Çekia per nje periudhe te gjate dhe banon ne Britanine e Madhe.

Nuk eshte bere e mundur pyetja e shtetasit Hamza Merxhani pasi ky shtetas nuk eshte gjetur nga ana e policise vendase dhe nuk njihet vendbanimi aktual.

Gjithashtu nga ana e autoriteteve gjyqesore ceke eshte derguar ne Prokurorine Prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nje kerkese per ndihme juridike ku kerkohet pyetja e shtetasit Nue Kalaj lidhur me transferten e perfituar prej tij nga ana e shoqerise CEZ sh.a.

Nga permbajtja e kerkeses se autoriteteve te lartpermendura rezulton se shoqeria CEZ i ka dorezuar autoriteteve te policise 2 fatura te printuara nga personi Nue Kalaj e konkretisht fature me numer 4600280490 me date 29.05.2009 me emertimin e pageses SUCCSESS FEE ACCORDING TO THE CONSULTING AGREEMENT me emer te Nue Kalaj, me shumen me vlere 5.000.000 EURO dhe nje fature me numer 2012000012350806 me date 29.05.2009 me emertimin e pageses SUCCSESS FEE ACCORDING TO THE CONSULTING AGREEMENT me emer te Nue Kalaj, me shumen me vlere 1.854.400 EURO.

Nga permbajtja e kerkeses se lartpermendur rezulton gjithashtu se shoqeria CEZ i ka skartuar te gjitha kontratat dhe dokumentat per te dyja faturat dhe gjithcka qe ka lidhje me personin Nue Kalaj. Kjo ka ndodhur pasi eshte respektuar afati kohor prej 5 vitesh per skartimin e dokumentave si dhe per arsye se kontrata me personin Nue Kalaj dhe kontrata te tjera nuk kane qene dokumente baze kontabiliteti.

Nga permbajtja e kerkeses se lartpermendur rezulton gjithashtu se me Aktin e ekspertimit nga Dega e Ekonomise te kerkuar nga autoriteti policor cek nuk eshte verifikuar per arsye te mungeses se kontrates me personin Nue Kalaj dhe per mungese dokumentash te nevojshme per ekspertin, qe pagesa e faturave te paguara nga shoqeria CEZ personit Nue Kalaj nuk ka qene nga ana ekonomike jo e rendesishme. Shuma e pergjithshme e paguar nga shoqeria CEZ per kontraten e realizuar personit Nue Kalaj akoma gjendet ne nivelin e fitimit te pranueshem, edhe pse maksimal, por duke u bazuar tek sasia e saj, dhe duke marre parasysh te ardhurat e shoqerise CEZ, vleresohet si nje shpenzim marginal.

Deri tani, citohet ne leteroprosi, nuk jane gjetur fakte ose informacione per sjellje korrupsioni ne Republiken e Cekise, as jashte shtetit, do me thene ne Shqiperi.

Nga ana e Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me qellim kryerjen e te gjitha detyrave te lena nga ana e gjykates, i eshte rikerkuar autoriteteve kosovare, nepermjet leterporosise se derguar me date 17.04.2019 pyetja e shtetasit Nue Kalaj.

Me shkresen nr.1887/3 prot.A.H date 26.11.2019, te Ministrise se Drejtesise se Republikes se Shqiperise jane percjelle aktet e derguara nga autoritetet kosovare ne ekzekutim te leterporosise. Nga studimi i akteve te derguara nga autoritetet kosovare rezulton se ky shtetas perseri nuk eshte gjetur dhe ka informacione qe mund te jetoje ne France prej vitesh.

Ne perfundim te hetimeve dhe per sa u analizua me siper, nga ana e organit te prokurorise arrihet ne konkluzionin se edhe pas kryerjes se veprimeve hetimore te lena detyre nga gjykata me vendimin nr.240 akti date 15.12.2017, dhe ato te kryera ne dinamike nga ana e prokurorise, nuk arrihet te provohet pertej cdo dyshimi te arsyeshem ekzistenca e elementeve te vepres penale te “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal rrjedhimisht edhe te veprës penale të “Pastrimit të produkteve te vepres penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe ne keto kusht gjykoj se ceshtja penale duhet te pushohet.

Sa me siper pasi asnje nga veprimet e kryera dhe provat e marra pas rrezimit te kerkeses se pare te paraqitur nga ana e Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se

Pare Tirane, nuk rezulton te cenoje argumentat e paraqitura po nga ana e organit te prokurorise lidhur me pushimin e ceshtjes penale.

Vlerësimi i Gjykatës.

Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror.

Organi i prokurorisë ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrejë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari. Akuza është procedimi penal i një personi, ndaj të cilit bien dyshime si autor i kryerjes së një veprë penale, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar.

Ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një veprë penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Elementë të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, kqyrja dhe kontrolli i personit ose i banesës, sekuestrime, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera. Të gjitha këto hapa kryhen nën drejtimin dhe përgjegjësinë ekskluzive të prokurorit, i cili që në momentin që vihet në dijeni të veprës penale, kryen çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm për identifikimin e autorit të kësaj veprë dhe marrjen e tij në përgjegjësi penale.

Për të garantuar jo vetëm qenien aktive të organit të prokurorisë në ndjekjen penale dhe dënimin e personave të dyshuar si autorë të veprave penale, por edhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve ndaj të cilëve ngrihet akuza ose janë dëmtuar si pasojë e veprës penale konkrete, ligjvënësi ka parashikuar në disa dispozita të K.Pr.Penale mundësinë që palët në proces për çdo veprim që ata mendojnë se cenojnë të drejtat dhe liritë e tyre t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës për kontroll. Neni 278 i K.Pr.Penale parashikon se gjatë hetimeve paraprake për rastet e parashikuara nga ligji mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit dhe të viktimës vendos gjykata. Në dispozitat e tjera të K.Pr.Penale, janë specifikuar disa nga rastet kur lejohet ankimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake.

Në K.Pr.Penale janë parashikuar në mënyrë shteruese kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, ku nder te tjera, gjyqtari i seancës paraprake shqyrton kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të Kodit Procedures Penale. Kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, prokurorit, pandehurit, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, në një seancë me dyer të mbyllura, por duke u garantuar parimi i kontadiktoritetit midis palëve, ku dhe figura e mbrojtësit është e detyrueshme. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.

Gjyqtari i seancës paraprake shqyrton të kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të Kodit Proçedures Penale dhe dëgjon pretendimet e palëve merr vendim, i cili, kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes. Në rast të kundërt, gjykata vendos sipas parashikimeve të shkronjës “b” ose “c”, të paragrafit 3, të nenit 329, të Kodit Proçedures Penale. Kur gjykata vendos sipas shkronjës “b”, të paragrafit 3, të nenit 329, të Kodit Proçedures Penale, i cakton prokurorit një afat për kryerjen e hetimeve. Kur është rasti, zbatohen rregullat e parashikuara nga paragrafi 4, i nenit 329, të Kodit Proçedures Penale. Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit. Zbatohen për aq sa janë të pajtueshme rregullat e përcaktuara në nenin 329 të Kodit Proçedures Penale.

Gjykata çmon se përpara se të merret vendimi për pushimin e akuzës ose çështjes, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të Kodit Proçedures Penale, gjyqtari i seancës paraprake **ka detyrimin të analizojë kryesisht nëse kërkesa e prokurorit për të pushuar çështjen është në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.** Prokuroria si autoriteti përgjegjës i procesit të hetimit ka përgjegjësinë për ushtrimin e të drejtës së procedimit penal duke zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm. Kjo parashikohet në nenin 24 të K.Pr.Penale, nën titullin “**Funksionet e prokurorit**”, ku thuhet shprehimisht se: “*1. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëzon akuzën në gjyq në ermër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikqyr ekeutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë kod. 2. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë akuzën ose çështjen, ti kërkojë gjykatës pushimin e akuzës ose çështjes, si dhe të kërkojë dërgimin e çështjes në gjyq, sipas rasteve të parashikuara në këtë Kod.*”, dhe në nenin 304 të këtij Kodi, nën titullin “**Veprimtaria hetimore e prokurorit**”, ku thuhet se: “*1. Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm.*”. Pra, në këtë kontekst prokuroria duhet të kryejë të gjitha veprimet e mundshme hetimore për të provuar a) ekzistencën e faktit penal dhe b) autorin e veprës penale. Mbase të ketë sqaruar këta elementë të hetimit dhe të ketë konkluduar, duhet të analizojë nëse ka shkaqe padënueshmërie.

Sipas të drejtës sonë penale e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal. Respektimi dhe plotësimi i elementeve të figurës së veprës penale ka rëndësi të madhe, sepse ka të bëjë me zbatimin e parimit të ligjshmërisë. Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provuashmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë ligjorë, personi nuk mund të merret nën përgjegjësi penale dhe rrjedhimisht as të dënohet. Prandaj, në çështjen konkrete, gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet. Për rrjedhojë,

gjqytari i senancës paraprake në zbatim të nenit 329/b pika 3, të K.Pr.Penale duhet të vendosi pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi.

Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: “1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. **Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.**”. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: “Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është **in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit** dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat.”. Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit (“akuzës”, “veprës penale” për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në bazë të këtij parimi pranohet se **kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri shpallet i pafajshëm atëherë kur organi i akuzës nuk ka arritur të provojë në gjykatë se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës ose kur ekziston një dyshim për akuzën**, i cili sipas parimit të njohur *in dubio pro reo*, çmohet nga gjykata në favor të të pandehurit.

Gjithashtu, për sa i përket standartit të provueshmërisë në procesin penal, Gjykata mban parasysh jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë. Kështë, në vendimin Nr. 196, datë 12.06.2013 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera shprehet: “Kolegji Penal risjell në vëmendje edhe vendimin që i përket çështjes “Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr.44438/06, datë 21.07.2011 kur, GjEDNj përvijon jurisprudencë të qartë, në lidhje me mundësinë dhe vlerën e përdorimit të akteve, si dhe kualifikimit të akuzave nga ana e gjykatave të faktit. “Sipas jurisprudencës së krijuar nga gjykata, të gjitha provat duhet të merren në një seancë publike, në prani të të akuzuarit, me qëllim të mundësisë së kundërshtimit të tyre. Ka përjashtime nga ky parim, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes, që sipas rregullit të përgjithshëm, të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6, kërkojnë që të pandehurit t’i jepet një mundësi e përshtatshme dhe e duhur, për të paraqitur kundërshtimet e rastit dhe për t’i bërë pyetje dëshmitarit, si në fazën e deklarimeve ose në një fazë të mëvonshme. **Në veçanti, të drejtat e mbrojtjes kufizohen, në një masë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6, nëse dënimi është i bazuar vetëm, ose në një mënyrë vendimtare, në deklarimet e një dëshmitari, për të cilat i akuzuari nuk ka pasur mundësi të vijë në dijeni dhe t’i kundërshtojë gjatë hetimit ose gjykimit** (shiko dhe A.M. kundër Italisë, nr.37019/97, § 25, ECHR 1999-IX). (“Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr.44438/06, datë 21.07.2011, §43).”, ndërsa në vendimin Nr. 97, datë 20.03.2013 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se: “Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton se të dy gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në një provë të vetme, siç janë bisedat telefonike, të cilat sipas vlerësimit të gjykatave të faktit, janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve dhe pa i analizuar ato me asnjë provë tjetër, direkte ose indirekte, që provon fajësinë e të pandehurve, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke i dhënë kësaj prove vlerë të paracaktuar.”. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve

rezulton se askush nuk mund të dënohet me një provë të vetme, e cila nuk lidhet me prova të tjera.

Gjykata çmon se, është fakt i njohur që procesi i çmuarjes së provave është proces i ndërlikuar dhe kompleks, pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet trupi gjykues në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej tij, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që doemos duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale. Në nenin 152 të K.Pr.Penal nën titullin “**Çmuarja e provave**” parashikohet shprehimisht se: “1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.”, ndërsa në nenin 380 të K.Pr.Penale nën titullin “**Provat që mund të përdoren për të marrë vendimin**” parashikohet shprehimisht se: “1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se çdo provë vlerësohet në unitet me provat e tjera që do të thotë se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, në të kundër nuk do të kishim çmuarje të provave. Pra, çmuarja e provave përbëhet prej veprimeve të Gjykatës për përcaktimin e vërtetësisë dhe mjaftueshmërisë së provave.

Vërtetësia e provave është përcaktimi i saktësisë së fakteve provuese domethënë arritja në përfundimin nëse një provë i përgjigjet ose jo së vërtetës.

Mjaftueshmëria e provave është përcaktimi që bëhet se bashkësia dhe tërësia e tyre lejon nxjerrjen e përfundimit të vërtetë për ekzistencën e faktit për të cilin ato (prova) janë mbledhur. Në qoftë se në bazë të provave të mbledhura është e pamundur arritja e një përfundimi të tillë, kjo gjë tregon se provat nuk janë të mjaftueshme. Në nenin 152 të K.Pr.Penale është sanksionuar parimi i çmuarjes së lirë të provave. Provat shqyrohen sipas bindjes së brendshme duket zbatuar metodën dialektike gjatë vlerësimit të provave, sipas kësaj metode vërtetësinë e provave duhet ta shikojmë në lidhje të përgjithshme dhe varësi reciproke me provat e tjera dhe me faktet e çështjes, pra duhet ta shikojmë në mënyrë të gjithëanshme.

Me bindje të brendshme, kuptojmë atë ndjenjë që formohet tek organi procedues në bazë të ndijimeve të përshtypjeve të tij për drejtësinë e përfundimeve të arritura për saktësinë dhe mjaftueshmërinë e provave. Bindja e brendshme formohet nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Kjo kërkesë e ligjit ka për qëllim që të detyrojë Gjykatën që para se ajo të arrijë në përfundimin e saj, lidhur me vlerësimin e provave, të marrë në shqyrtim jo vetëm njëri anë të provës që bën fjalë për vërtetësinë e saj, por dhe anën e kundërt që e ve në dyshim ose e mohon këtë vërtetësi, **që gjykat të mbështetet jo vetëm te një provë, por në disa të tilla**, që duke i vlerësuar në tërësinë e tyre të lejojnë jo nxjerrjen e një përfundimi hipotetik por një të vetëm dhe të pakundërshtueshëm.

Për të përcaktuar vlerën që ka jurisprudenca konstante e Gjykatës së Lartë në interpretimin e ligjit, për gjykatat e zakonshme, Gjykata mban parasysh vendimin Nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera thuhet se: “9. Gjykata vlerëson t’i referohet konceptit të së “drejtës së gjallë”, e kuptuar përgjithësisht në sensin e ekzistencës së një “jurisprudence konstante”, “të konsoliduar” mbi një dispozitë të caktuar ligjore (duke pasur pra parasysh mënyrën se si ajo “jeton” në realitetin konkret). Përdorimi i formulës së “të drejtës së gjallë” e ndihmon Gjykatën të përcaktojë raportet me gjyqtarët e zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u

*takon posaçërisht këtyre të fundit) duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues (self restraint) në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysh dhe (me disa përjashtime) nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse. **Kompetenca e Gjykatës ndalet përpara interpretimit konstant jurisprudencial pasi, edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njeh normës legislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte por ato që zbatohen në punën e përditshme të gjyqtarit, që synon t'i bëjë konkrete dhe efikase (shih vendimin nr.350, datë 13-21 nëntor 1997, të Gjykatës Kushtetuese Italiane).**”.*

Gjykata çmon se, subjektet e procesit penal, janë të detyruara të respektojnë parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të sigurisë juridike. Kuptimi i parimit të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike është dhënë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Kështu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj thekson, se nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës, buron e drejta e kujtdo, që pretendon se të drejtat ose liritë e tij janë cenuar, për një gjykim të drejtë përpara një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj; që kjo e drejtë nuk mund të kufizohet artificialisht dhe që zbatimi i saj nuk duhet të pengohet në mënyrë të paarsyeshme; që e drejta e individit kundër veprimeve të paligjshme të individëve të tjerë apo institucioneve shtetërore nuk duhet të mbrohet vetëm formalisht, por dhe realisht e efektivisht. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e ka theksuar vazhdimisht në jurisprudencën e saj rëndësinë e parimit të sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Siguria juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike si një nga përbërësit themelore të shtetit të së drejtës. Ky element theksohet edhe në një sërë vendimesh të mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtarë të krijuar për garantimin e të drejtave të njeriut.

Në rastin konkret, në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal është marrë me anë të procesverbalit të datës 05.07.2017, në mbështetje të neneve 93 etj të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i pushimit të procedimit penal nr.1, datë 11.02.2017 i Prokurorisë së Përgjithshme.

Objekt i këtij hetimi, ka qenë materiali kallëzues i depozituar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI).Kjo prokurori, ka regjistruar procedimin penal nr.1 viti 2016, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal.

Sipas këtij vendimi rezulton se “Ministria e Energjitikës dhe Industrisë (MEI), kallëzimin e saj e ka mbështetur në të dhënat e raportit të Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, i kryer lidhur me rregullshmërinë e procesit të privatizimit të shoqërisë OSSH sha, nënshkrimin të marrëveshjes për shitjen e 76% të aksioneve të kësaj shoqërie (MSA) dhe zbatimit të kësaj marrëveshje. Nga të dhënat e raportit të Auditit të Brendshëm, kanë rezultuar fakte dhe rrethana të paligjshme të cilat krijojnë dyshimin se përbëjnë elementë të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i K.Penal, të kryera nga funksionarë publik, të cilët me veprimet e mosveprimet e tyre, kanë favorizuar hapur ofertuesin e shpallur fitues “CEZ as”. Gjithashtu në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në

fuqi, kanë vijuar me favorizime edhe në etapat e tjera gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, duke i sjellë shoqërisë CEZ Shpërndarje përfitime materiale të padrejta, të cilat kanë dëmtuar rëndë interesat e ligjshme të shtetit shqiptar dhe të personave të tjerë juridikë.”

Kallëzimi penal është ngritur kundër shtetasve Genci Ruli, me detyrë ish Ministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës, aktualisht deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Neritan Alibali, me detyrë ish Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës, Enno Bozdo, me detyrë ish Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës, Florjon Mima me detyrë ish Ministër i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës, aktualisht deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Ridvan Bode me detyrë ish Ministër i Financave, aktualisht deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Suzana Guxholli, ish Këshilltare pranë ish Kryeministrit, etj.

Në përfundim të hetimit të këtij procedimin penal, prokuroria ka vendosur më datë 13.07.2016 pushimin e hetimeve bazuar në nenin 328 pika “1”, gërma “b” të Kodit të Procedurës Penale, duke arësytuar se:

“.....nga gjithë hetimet e kryera, sikurse janë, aktet e paraqitura në kallëzimin e MIE, aktet e marra dhe të administruara me vendim kqyrje dhe marrje gjatë hetimit paraprak, dëshmime të personave që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe të gjitha veprimeve të tjera hetimore, ka rezultuar se gjendemi para një procedure prokurimi të kryer në përputhje me ligjin, akteve nënligjore në fuqi dhe të një procedure të miratuar nga organet kompetente për privatizimin e shoqërisë OSSH sh.a. ku në përfundim është nënshkruar marrëveshja për blerjen e aksioneve të firmosur më datë 11.03.2009 dhe miratuar përfundimisht nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, me ligjin nr. 10116, datë 23.04.2009, botuar në fletoren zyrtare nr. 60 datë 14.05.2009.....

Zhvillimi i procesit për privatizimin e shoqërisë OSSH sh.a, rezulton se është tërësisht i bazuar në Kushtetutë dhe aktet ligjore e nënligjore....”

....Në përfundim dhe si konkluzion, nga hetimet e kryera në kuadër të këtij procedimi penal rezulton se faktet e provuara nga hetimi dhe të përshkruar më sipër në këtë vendim, nuk parashikohen nga ligji si vepër penale e “Shpërdorimit të detyrës”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal.

Gjithashtu fakti i provuar nga hetimi nuk parashikohet nga ligji, as si ndonjë vepër tjetër penale e parashikuar në Kodin Penal.”

Në lidhje me këtë vendim, është ushtruar ankim pranë Gjykatës së Lartë nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Gjykata e Lartë, me anë të vendimit të saj të datës 21.11.2016, ka arësytuar se *“Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e gjen të drejtë vendimin Prokurorisë së Përgjithshme për Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.1 të vitit 2016, regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal, si një vendim të dhënë në zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural penal. Ky vendim është rrjedhojë e kuptimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit penal dhe, si i tillë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se ai do të lihet në fuqi.”*

Gjykata e Lartë, në përfundim, ka vendosur *“Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga MEI, me objekt “Kundërshtimin e vendimit datë 13.07.2016 për pushimin e procedimit penal nr.1, të vitit 2016 të Prokurorisë së Përgjithshme.”, me arsyetimin se “...vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është marrë në zbatim të nenit 328/1/b të*

K.Pr.Penale, pasi fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për rrjedhojë, duhet të rrëzohet kërkesa e paraqitur nga ankuesi Ministria e Energjisë dhe Industrisë, pasi nuk është e bazuar në ligjin procedural penal....”

Në këto kushte, sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, rezulton se e gjithë procedura e ndërrmarrë për privatizimin e OSSH-së është konsideruar si e bazuar tërësisht në kushtetutë dhe bazën ligjore.

Sa më sipër, referuar kallëzimet penale të kryera nga shtetasi Romeo Kara dhe Kuvendi i Shqipërisë, për pjesën të këtyre kallëzimeve që kanë si objekt procedurën e privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negociimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr.10116, datë 23.04.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ-a.s-së” si dhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, jemi në kushtet e parimit të “gjësë së gjykuar”. Duke vlerësuar rëndësinë e parimit të sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, pasi parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike, përcaktimi i këtyre fakteve bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike si një nga përbërësit themelore të shtetit të së drejtës, Gjykata merr në analizë edhe këtë parim të së drejtës në rastin konkret.

Në lidhje me këtë parim, është i konsoliduar qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese si dhe i Gjykatës së Lartë me një sërë vendimesh. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.10 dt.02.04.2009 ka mbajtur këtë qëndrim: “...Gjykata Kushtetuese vëren, se dispozita e nenit 135 të Kushtetutës, sipas të cilës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga [gjykatat] Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, në aspektin procedural penal, do të thotë se një person nuk mund të deklarohet fajtor për kryerjen e një veprë penale dhe as mund t’i jepet një dënim penal, pa një vendim gjyqësor, të marrë në bazë të ligjit. Gjykata Kushtetuese vë në dukje, se funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kur ushtron ndjekjen penale prokurori vetëm mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale, apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit, vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë, se në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal, është gjykata që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori. Për pasojë, pushimi i akuzës ose i çështjes penale nga prokurori, në vetvete, nuk barazohet me pafajësinë e të pandehurit (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 21.07.2008)....

...ideja e parimit ne bis in idem nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtës normë penale, por tek mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për “të njëjtën vepër penale”, për të cilën ai është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Nëse gjenden elementë të njëjtë parimi ne bis in idem ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 08.03.2005).

Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme rezulton se parimi ne bis in idem nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elementë të njëjtë. Parimet e

sanksionuara në nenin 34 të Kushtetutës dhe nenin 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ parashikojnë, se një person i gjykuar dhe i dënuar me vendim të formës së prerë nuk mund të procedohet dhe të gjykohet përsëri për të njëjtën akuzë, që duhet kuptuar për të njëjtin fakt...”

Në vendimin Nr. 282, datë 15.03.2007 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ndër të tjera thekson se: *Në rastet kur vendoset pushimi i procedimit apo i jepet pafajësi, personi rifiton të gjitha të drejtat dhe cilësia e tij si i pandehur rimerret vetëm në rastet kur shfuqizohet vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes. Ndodhur para një vendimi për pushimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit G.h i pa shfuqizuar nga prokurori, procedimi ndaj tij nuk mund të vazhdojë e duke qenë se ky pretendim ka vazhduar, gjithë aktet janë absolutisht të pavlefshme.*”

Paragrafi i dytë i nenit 4 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lejon që elementët dhe faktet e veprës së mëparshme të diskutohen vetëm në raste rigorozisht të përcaktuara: dalin fakte të reja ose të zbuluara rishtas, një ves themelor në procedurën e mëparshme që janë të një natyre të tillë që mund të çenojnë vendimin e dhënë. Nëse këto raste nuk vërtetohen, çështja e mëparshme nuk mund të diskutohet më dhe as të bëhet pjesë e elementeve të veprës së re.

Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata e Lartë, me vendimin e saj të datës 21.11.2016, në përfundim, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga MEI, me objekt “Kundërshtimin e vendimit datë 13.07.2016 për pushimin e procedimit penal nr.1, të vitit 2016 të Prokurorisë së Përgjithshme.”, me arsyetimin se “...vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është marrë në zbatim të nenit 328/1/b të K.Pr.Penale, pasi fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, për rrjedhojë, duhet të rrëzohet kërkesa e paraqitur nga ankuesi Ministria e Energjisë dhe Industrisë, pasi nuk është e bazuar në ligjin procedural penal....”

Në këto kushte, sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, rezulton se e gjithë procedura e ndërmarrë për privatizimin e OSSH-së është konsideruar si e bazuar tërësisht në kushtetutë dhe bazën ligjore dhe për pjesën e kallëzimeve penale të kryera nga shtetasi Romeo Kara dhe Kuvendi i Shqipërisë, që kanë si objekt procedurën e privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr.10116, datë 23.04.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ-a.s-së” si dhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, jemi në kushtet e parimit të “gjësë së gjykuar” prandaj për këtë pjesë nuk mund të diskutohet më. Gjithashtu edhe të gjitha aktet e hetimit të prokurorisë pas vendimit të Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Përgjithëshme për pushimin e çështjes janë absolutisht të pavlefshme, perderi sa ai vendim është në fuqi.

Përsa i përket procedimi penal nr. 7340, të filluar për veprat penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 245/1 dhe 287 të Kodit Penal, Gjykata, në analizë të elementëve të figurës së veprës penale të “**Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike**”, parashikuar nga neni 245/1, të Kodit Penal, konstaton se në këtë nen parashikohet shprehimisht se:

“Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtim ose siguron se është në

gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.”.

Në lidhje me **objektin e veprës penale, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”** gjykata thekson se, në kuptim të dispozitës së **nenit 245/1**, të Kodit Penal, gjykata thekson se qëllimi i mbrojtjes së marrëdhënies juridike nga norma penale e parashikuar në nenin 245/1 të Kodit Penal, është mbrojtja dhe ruajtja e ushtrimit të ligjshëm të funksioneve publike, si dhe ruajtja e besimit që individët kanë tek funksionarët që ushtrojnë detyra publike në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe besnikërisë së ushtrimit të detyrës publike, duke i shërbyer me përpikëri vetëm interesave publikë në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në bazë të nenit 107/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nëpunësit publikë (dhe jo vetëm ata civilë) zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. Prandaj, edhe ushtrimi i detyrës publike duhet të udhëhiqet vetëm nga respektimi i ligjit dhe shërbimi ndaj interesave publike, dhe jo i atyre interesave të tjera private të shkëmbimit që nuk duhet të mbivendosen apo të dalin mbi ndjekjen e interesave publike. Gjkata vëren se vepra penale e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, është parashikuar si rezultat i angazhimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në Konventën penale të Këshillit të Evropës për korrupsionin, ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001, ndryshuar me ligjin nr. 9369, datë 14.04.2005, si dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13.03.2006. Neni 18 i Konventës në fjalë synon, jo vetëm ndalimin dhe ndëshkimin e veprës penale të korrupsionit, por edhe të atyre veprave të tjera penale që e favorizojnë dhe e nxisin atë. Në nenin 12 të Konventës penale të Këshillit të Evropës për korrupsionin, është parashikuar angazhimi që, secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim premtimin, dhënien ose ofrimin, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon cilitdo që siguron ose konfirmon se është i aftë të ushtrojë ndikim në vendimmarrjen e cilitdo personi të referuar në nenet 2, 4, 5, 6, 9, 10, 11, në përputhje me këtë dispozitë, kur avantazhi që nuk i takon është për atë vetë, apo për të tjerë, sikurse dhe kërkimi, marrja ose pranimi i ofertës ose premtimi i një avantazhi të tillë, në përputhje me këtë ndikim, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose jo, ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar çon ose jo në rezultatin e synuar. Sipas relacionit shpjegues të Konventës, ky nen ka për qëllim mbrojtjen e transparencës dhe paanshmërisë së administratës publike. Neni 12 i Konventës, garanton luftën e gjithanshme ndaj dukurisë së korrupsionit në të gjitha format e shfaqjes së tij si kërcënim ndaj sundimit të ligjit dhe stabilitetit të institucioneve demokratike. Kriminalizimi i kësaj vepre penale synon të parandalojë rrethin e ngushtë të zyrtarëve apo të subjekteve politike, duke ndaluar ndikimin e paligjshëm të atyre që janë afër me zyrtarin dhe ushtrimin e pushtetit publik a privat dhe që përfitojnë favore të parregullta prej pushtetit.

Në lidhje me **anën objektive të figurës** së veprës penale **“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”** Gjkata thekson se ajo

është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: *i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e vepërës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe *iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjenë rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

Në kuptim të nenit 245/1, paragrafi 2 të Kodit Penal, që të kemi konsumimin e anës objektive të veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, nga ana objektive kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme: 1) nga ana aktive, duke premtuar për t'i ofruar, ose propozuar ose dhënë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt personit, i cili premtun ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike. Ndërsa nga ana pasive: 2) kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë nga personi që ka kërkuar këtë veprim. Dallimi midis nenit 245/1 të Kodit Penal dhe nenit 319/ç, qëndron në shkakun e përfitimit të parregullt, në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, përfitimi i parregullt jepet apo kërkohet për shkak të mundësisë së ndërmjetësimit të krijimit të një marrëdhënie të kundërligjshme midis korruptuesit dhe të korruptuarit, pra jo për shkak të ushtrimit apo mos ushtrimit të detyrës së nëpunësit publik. Në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal nuk parashikohet lidhja midis ushtrimit të detyrës midis funksionarit publik dhe ushtruesit të ndikimit të paligjshëm, pasi sjellja e subjektit aktiv që kryen ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndodh më përpara dhe jashtë kryerjes së marrëdhënies korruptive midis të ndërmjetësuarit dhe të korruptuarit

Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, Gjykata çmon se Vepra penale e “Ushtrimit të ndikimit”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, në rastin konkret lidhet ngushtësisht me procesin e privatizimit të OSSH-së. Duke ju përmbajtur dispozitës, neni 245/1, pikë së pari, duhet të ekzistojë premtimi, propozimi ose dhënia drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë i çfarëdo **përfitimi të parregullt për vetë ose persona të tjerë...** Referuar akteve të hetimit paraprak, është konkluduar se nuk provohet të jetë dhënë një përfitim i tillë i çfarëdolloji. Përfitimi në këtë rast nënkupton një lidhje të drejtpërdrejtë me vendimarrjen. Vendimarrja në rastin konkret ka si produkt të saj procedurën e privatizimit të OSSH-së.

Sic u tha edhe më lart, kjo procedurë e zhvilluar lidhur edhe me pretendimevet e palëve të listuara më sipër, ka qenë objekt i një hetimi në kuadër të procedimit penal nr.1/2016, i cili e ka konsideruar atë të kryer konform ligjeve dhe kushtetutës. Në këtë procedim penal është marrë në shqyrtim e gjithë procedura e zhvilluar. Sic u tha edhe më sipër, Gjykata e Lartë ka rrëzuar ankimin e ngritur nga ana e kallëzuesit Ministrisë së Energjetikës.

Në kallëzimet penal, është pretenduar se ndikimi është kryer nga ana e shtetasit Nue Kalaj, i cili rezulton të kishte njohje me shtetasin Shkëlzen Berisha dhe ka përmendur në një e-mail dhe kryeministrin e asaj kohe, zotin Sali Berisha. Në përmbajtjet e e-maile-ve pavarësisht, se shihet interesimi i shtetasit Nue Kalaj në lidhje me procedurën e privatizimit dhe hidhet dritë mbi faktin se ai kishte kohë që punonte pranë kompanisë CEZ, me focus të punës së tij kishte përhapjen e saj në tregun shqiptar, nuk përmend në asnjë rast dhe nuk rezulton të ketë ushtruar ndikim në asnjë lloj forme, qoftë edhe të nënkuptuar dhe as rezulton të ketë kërkuar përfitime të paligjshme për të premtuar kryerjen këtij ndikimi.

Nga përmbajtja e e-maileve, jepen informacione në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes dhe në tërësi objektin e saj, si në lidhje me borxhin, huatë, nënshkrimin e marrëveshjes etj.

Në përmbajtjen e tyre ai flet për probabilitet në kryerjen e veprimeve nga ana e qeverisë shqiptare, por në asnjë rast nuk flitet për premtime konkrete, realizim “negociatash” ose e thënë ndryshe, bisedimesh mes tij dhe personave që kryejnë ndikim dhe marrim përsipër kryerje të ndikimit.

Në njërin nga e-mail-et thuhet se ka shtrënguar duart më kryeministrin dhe se ai është i kënaqur të presë shtetasin Tomas Pleskash. Ky takim sic del është kryer në një takim me investitorët. Ky pohim nuk shoqërohet me asnjë të dhënë tjetër që të nënkuptojë se tek ai është ushtruar ndikim për të kryer një gjë të tillë. Nga përmbajtja e e-mail-it rezulton se takimi me të birin do të kryhej një ditë më pas, c’ka nënkupton se në momentin që kryeministri ka shfaqur kënaqësinë për takimin, takimi me këtyre personave nuk ishte realizuar. Nga ana e kallëzuesve ngrihet pretendimi se në periudhën janar 2008 deri në qershor të vitit 2009, kompania “CEZ group” a.s. nëpërmejt një banke të nivelit të dytë, ka kryer transksione parash në favor të shtetasit Nue Kalaj shuma prej 6.854.248 (gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzetë e tëtë) euro, në datë 12.06.2009, pa dokumentacion justifikues nga banka.

Shuma e mësipërme, nuk mund të konsiderohet si përfitim në kuadër të arësytimit të mësipërm, pasi nuk rezulton që nga kjo shumë të jetë kryer ndonjë transaksion i mëtejshëm në favor të ndonjë përfituesi i cili mund të kryejë ndikim.

Nëse i referohemi, kohës në të cilën është bërë kalimi i shumës dhe në tërësi, periudhës gjatë së cilës janë kryer transfertat, del se transfertat e fundit mban datën 12.06.2009, ndërsa emaillet e tjera, ku përmendet takimi me të birin, duke nënkuptuar kryeministrin dhe lidhjen e tij me shtetasin Shkëlzen Berisha, janë kryer kohë më vonë, në vitet 2010 e në vijim.

Në vijim të përmbajtjes së nenit 245/1 të Kodit Penal, analizohet se elementët e anës objektive janë propozimi, premtimi apo dhënia...e përfitimit të paligjshëm personit që premtim ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm...(sipas paragrafit të parë) dhe kërkitimi, marrja ose pranimi ... i përfitimit të parregullt ...duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës...(sipas paragrafit të dytë).

Nga përmbajtja e e-mail-eve nuk rezulton të jetë premtuar ndikimi tek ndonjë person konkret në një mënyrë konkrete. Në e-mail-in e datës 07.09.2009, ora 13:51 pm, Nuel Kalaj ofron shërbimin për të bashkëpunuar me drejtuesit e CEZ Albania për të shmangur marrjen e një borxhi kompanisë CEZ. Pra sic shihet, në këtë rast është ofruar ndihmë në kuadër të shoqërive, pa përmendur asnjë institucion shtetëror apo person që ushtron funksion publik.

Në emailin e datës 11.05.2010, ora 10:00 me dërgues Nuel Kalaj, drejtuar Tomas Plesksh, zv/drejtor i CEZ Group, me subject “Kosova”, informon në lidhje me faktin se qeveria shqiptare po përgatitet për të marrë një hua dhe e konsideron këtë si një problem. Ky fakt qëndron në kuadër të një informacioni.

Në e-mail-in e datës 15.05.2010 ora 12:05, dërguar Jozef Hejsek, Nue Kalaj shprehet se do të vërë në dijeni zotin Martin Roman dhe vetë kryeministrin në lidhje me situatën. Ai përmend Merxhanin dhe drejtues të tjerë dhe shprehet se ai mund të shpallet person non gratta nga qeveria shqiptare. Përmend, gjithashtu, edhe faktin, se nëse kryhet investigim, mund të tronditen nga themelet kompania. Nga përmbajtja e këtij e-mail-i nënkuptohet parregullsi në punën e Hejsek, të cilat Kalaj i cmon si të tilla që mund ta bëjnë atë person të padëshiruar në territorin shqiptar, duke përmendur dhe pasoja për shoqërinë CEZ, të cilat kanë rrejdhojë pikërisht punën e Hejsekut. Në këtë e-mail Kalaj deklaron se nuk merret me persona të përfshirë në korrupsion dhe japin informacione të rreme në lidhje me situatën. Kjo hedh dyshime se persona të tillë, janë Hejsek dhe të tjerë të paidentifikuar.

Në e-mail-in e datë 17.11.2011, ora 03:37 është Josef Hejsek ai që informon Kalajn se kanë qenë këshilluar se sot është dita e duhur për të dorëzuar njoftimin për rastin e garancisë së pjesshme të rrishtit duke reflektuar vendimin e ERE-s, lidhur me studimin e borxhit të keq të Deloitte.

Përsa i përket kallëzimit për konsumimin e elementëve të veprës penale të **Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**”, në nenin 287 të Kodit Penal parashikohet shprehimisht se:

“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave ();

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.”.

Në lidhje me objektin e veprës penale, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimitarisë kriminale”. Objekti i kësaj vepre penale përfaqëson tërësinë e marrëdhënieve juridike të vendosura nga ligjvënësi me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt dhe normal të organeve të administratës publike dhe mbrojtja e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale. Objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që pastrohet.

Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimitarisë kriminale”. Ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka veprë penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; mënyra e kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjenë rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

Në lidhje me nocionin **“produktit të veprës penale ose veprimitarisë kriminale”**, Neni 1 i Konventës së Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit” jep këtë përkufizim: *“Për qëllime të kësaj Konvente: a) “produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni; b) “pasuri” nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri;”*. Nocionin e “produktit të veprës penale” e gjejmë edhe në nenin 36 të Kodit Penal, i cili parashikon se: *“1.) Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale; b) të produkteve të*

veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;”. Parashikimi i nenit 36 të Kodit Penal në lidhje me nocionin e “produktit të veprës penale” është i ngjashëm me atë të nenit 1 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit”, që do të thotë se, produkt të veprës penale, do të kuptojmë çdo avantazh ekonomik i nxjerrë nga një veprë penale, i cili mund të konsistojë në pasuri të çdo natyre si dhe në dokumente apo akte juridike që vërtetojnë një titull apo një interes mbi këtë pasuri.

Në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal, figura e veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”**, nga ana objektive kryehet nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale është ndryshimi, kthimi në një gjë tjetër; zëvendësimi ose transferimi i një të drejte nga një person në tjetrin; transfertat elektronike të parave nga një llogari bankare në një tjetër janë të përfshira gjithashtu në këtë proces; konvertimi dhe transferimi i pronës me qëllim pastrimit i cili kryhet në mënyrë të fshehtë apo që fsheh origjinën e saj të paligjshme apo për të ndihmuar çdo person i cili është i përfshirë në kryerjen e një veprë penale. Transferimi është i definuar si kalimi i parave nga një pikë në një tjetër. Një kuptim tjetër është kalimi i remitancave nga një llogari në një tjetër në emër të të njëjtit person ose të personave të tjerë. Qëllimi i sjelljes së tillë është për të transformuar një pjesë të pronës në një tjetër, me synim për ta bërë atë legjitime, në mënyrë që prona e paligjshme të fillojë të bëhet e ligjshme. Ligji nuk duket se kufizon mënyrën në të cilën pasuritë këmbehen ose transferohen. Sigurisht që çdo lloj transaksioni financiar, si blerja e një çeku të arkëtueshëm, këmbimi i një çeku me një tjetër monedhë ose blerja e mallrave janë në përputhje me këtë përkufizim. Gjithashtu, edhe një transaksion jofinanciar si lëvizja apo dorëzimi i parave nga një person tek personi tjetër janë në përputhje me këtë përcaktim;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, **disponimit, zhvendosjes, pronësisë** ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Sipas “The Oxford English Dictionary”, të fshehtë do të thotë “të mbash sekret, të mos lejosh të shihet diçka”. Ajo i referohet largimit të një diçkaje nga një vend ku mund të shihet dhe vendosja aty ku askush nuk e di se ku është, duke e fshehur atë pikërisht sepse personi që e fsheh i di pasojat, dënimin. Sjellja e definuar këtu është për të fshehur, mbuluar apo për të maskuar burimin, vendndodhjen, disponimin ose lëvizjen e pronës. Kjo mund të kryhet nga një sjellje aktive - fshehur, maskuar, mbuluar ose pasive – në rastin kur subjekti ka një obligim ligjor për të vepruar. Sipas rregulloreve të Komisionit Amerikan të Kontrollit të Abuzimit me Drogën, fshehja i referohet një personi i cili pengon përcaktimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtave në lidhje me pronësinë e produktit. Me mbulim ose maskim siç njihet ndryshe sipas “The Oxford English Dictionary” definojnë termin “për të maskuar” si për të ndryshuar, për të fshehur, për të mbuluar identitetin. Dallimi kryesor në mes fshehjes dhe maskimit (mbulimit) është fakti se një person fsheh çfarë i takon atij apo asaj që rrezikon ligjërisht të konfiskohet, ndërsa maskimi ka të bëjë me fshehjen e akteve apo pronën e tjetrit. Po t’i referohemi Konventës së Vjenës 1988 (Neni 3/1) dhe Konventës së Palermos 2000 (Neni 6/2) vetëfshehja nuk dënohet, por dënohet veprimi i mëvonshëm i fshehjes. Maskimi është kriminalizuar tradicionalisht si një formë e pjesëmarrjes, nëpërmjet të ashtuquajturve bashkëpunëtorë

aposteriori, pas përfundimit të krimit. Maskimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendit, destinacionit, lëvizjes ose pronësisë së vërtetë apo i të drejtave që lidhen me pasurinë është diçka e dallueshme nga maskimet klasike siç janë kriminalizuar në shumicën e kodeve penale. Prandaj, ashtu si edhe modeli i krijuar nga Konventa e Vjenës, ky lloj maskimi është i ndryshëm nga vepra tradicionale e maskimit, pasi në veprën penale të pastrimit subjekti pa pasur nevojë të marrë pjesë në veprën penale dhe pa bashkëpunim të mëparshëm në kryerjen e tij, ndihmon autorin e veprës penale kryesore ose për të siguruar produktin e saj ose për të shmangur dënimin;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale.

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave. Kjo është një dispozitë blankete. Ndodhur në këto kushte, për të përcaktuar se kush janë ato veprimet ose transaksione që duhen raportuar duhet t'i referohemi Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar. Kështu, në nenin 2 të këtij ligji nën titullin "**Përkufizime**" parashikohet shprehimisht se: "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:...16. "**Transaksion**" është një marrëdhënie biznesi apo një shkëmbim që përfshin dy ose më shumë palë. 17. "Transaksione të lidhura me njëri-tjetrin" janë dy ose më shumë transaksione (duke përfshirë transfertat e drejtpërdrejta), ku secila prej tyre është më i vogël se sa shuma e përcaktuar si prag, në bazë të nenit 4 të këtij ligji dhe kur këto transaksione në shumë totale barazojnë ose tejkalojnë shumën e pragut të zbatueshëm.", ndërsa në nenin 4 të këtij ligji nën titullin "**Identifikimi i klientëve**" parashikohet shprehimisht se: "1. Subjektet duhet të identifikojnë klientët dhe të verifikojnë identitetin e tyre me anë të dokumenteve të identifikimit: a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi; b) kur klienti, në raste të ndryshe nga ato të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike, kryen ose kërkon të kryejë: - një transfertë të drejtpërdrejtë brenda ose jashtë vendit në një shumë të barabartë ose më të madhe se **100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja**; - një transaksion me një shumë të barabartë me: i) jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja për subjektet e përcaktuara në shkronjat "c" dhe "g" të nenit 3 të këtij ligji; ii) jo më pak se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm, ose në disa transaksione të lidhura me njëritjetrin. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm; c) kur ka dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë; ç) në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime të mjaftueshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit. 2. Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues.". Gjithashtu, në nenin 12 të këtij ligji nën titullin "**Raportimi tek autoriteti përgjegjës**" parashikohet shprehimisht se: "1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrajnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se periudha e përcaktuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. 2. Kur subjekti, të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim parash ose financim terrorizmi, ai duhet t'ia raportojë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Autoriteti përgjegjës është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 48 orëve. 3. Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë

autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, **të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja**, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën. 4. Subjektet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 3 të këtij ligji duhet t’i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, **të gjitha transaksionet jo në para fizike, në një shumë të barabartë në vlerë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja**, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.”, ndërsa në nenin 17 të këtij ligji nën titullin **“Raportimi i organeve doganore”** parashikohet se: **“1. Çdo person, shqiptar ose i huaj, i cili hyn/largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlera e saj në monedha të tjera të huaja, si dhe qëllimin e mbartjes së tyre, për të cilat duhet të paraqesë dokumente justifikuese. Autoritetet doganore duhet të dërgojnë tek autoriteti përgjegjës kopje të formularëve të deklarimeve të mësipërme dhe të dokumenteve justifikuese të paraqitura. Autoritetet doganore duhet t’i raportojnë menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që kanë lidhje me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre. 2. Organet doganore zbatojnë kërkesat e nenit 11 të këtij ligji.”**. Po ashtu, në nenin 19 të këtij ligji nën titullin **“Raportimi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”** parashikohet shprehimisht se: **“1. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme raporton brenda 72 orëve regjistrimin e kontratës së tjetërsimit të pronës me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja. 2. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme raporton menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë pranë autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhëna për pastrim parash apo financim terrorizmi për veprimtaritë nën juridiksionin e vet. 3. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme zbaton kërkesat e neneve 5 dhe 11 të këtij ligji.”**. Gjithashtu, nga ana objektive kjo figurë e veprës penale kryhet nëpërmjet: **d)** investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe **dh)** këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër.

Rrethana cilësuese parashikohen në paragrafin e dytë të nenit 287 të Kodit Penal në rastet kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një here, kur ajo është kryer më parë dhe pas saj, kryhet edhe herë të tjera. Gjithashtu, kusht i domosdoshëm është që i pandehuri të mos ketë qënë dënuar më parë për ndonjë nga episodet për të cilën kërkohet të gjykohej, sepse ndryshe quhet përsëritës në kuptimin e nenit 50 të Kodit Penal. Ndërsa në paragrafin e tretë të nenit 287 Kodit Penal parashikohet shprehimisht: **“E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.”**. Përsa i përket kuptimit të rrethanës cilësuese “pasoje të rënda”, Gjykata çmon të domosdoshme t’i referohet në mënyrë orientuese Vendimit Nr. 5, datë 11.11.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kështu, në këtë vendim thuhet se: “Interpretimi i termit “pasoja të rënda” duhet parë në raport me vetë figurën e veprës penale, me raportet shoqërore që ajo mbron dhe duhet analizuar në çdo rast me disa rrethana që lidhen me dëmin e shkaktuar nga vjedhja. Duke u nisur nga fakti që figura e veprës penale të vjedhjes, ka pasoje pakësimit e pasurisë së tjetrit në mënyrë të kundërligjshme, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë faktin se një ndër kriteret bazë për të përcaktuar pasojën e rëndë është vlera e

pasurisë së vjedhur e cila do të merret në çdo rast e lidhur me rrethanat e tjera që kanë ndikuar tek subjekti i dëmtuar. Ligjvënosi nuk e kushtëzon vjedhjen me vlerën dhe në paragrafin e dytë të nenit 134 nuk përmendet fjala vlerë, prandaj për të percaktuar “pasojën e rëndë”, duhet patur parasysh se ajo do të jetë e ndryshme mes subjekteve që dëmtohen nga vepra penale e vjedhjes që ndahen në: individë, persona juridike dhe shteti. Në raport me zhvillimin aktual ekonomik e gjendjen ekonomike të individit e të shoqërisë, Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë si kritere orientuese për vlerën si pasojë të rëndë në rastet e vjedhjes së parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal: 1. Shuma ose sende me vlerë mbi 1.000.000 leke kur ato u vidhen individëve. 2. Shuma ose sende me vlerë mbi 2.000.000 lekë kur vjedhja është realizuar në dëm të personave juridike dhe pasurisë shtetërore”.

Ashtu si shumica e kodeve penale në përputhje me detyrimet e akteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe rekomandimet e FATF e të Këshillit të Evropës, rezultojnë se dispozitat e nenit 287 të Kodit Penal zbatohen edhe kur vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet, ose është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Ndryshimet e bëra në Kodin penal me ligjin Nr.23 datë 01.03.2012 janë në përputhje të plotë dhe me detyrimet e Konventës së Varshavës të vitit 2005, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në Nenin 9 të së cilës parashikohet se “çdo palë do të sigurojë që një dënim i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprën penale kryesore nuk është parakusht për një dënim për pastrim parash”. **Midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (condicio sine qua non). Pra, nëse nuk kemi të konsumuar nga ana objektive një vepër penale mëmë nuk mund të filetohet për pastrim të produktit të saj, pasi produkti sipas nenit 287 të Kodit Penal, duhet të rrjedhë si rezultat i një fakti i cili parashikohet nga ligji si vepër penale. Prandaj, në çdo rast duhet që midis veprimeve të autorit të veprës penale që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së pasojës, pastrimi i produktit të veprës penale, duhet të ekzistojë lidhje shkakësore.**

Duke u rikthyer në rastin konkret nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti penal i cili i atribuohet të pandehurve ekziston. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë të dhënë konkrete që të pandehurit të kenë kryer ndonjë vepër penale konkrete që të gjenerojë të ardhura, të cilat më pas të pastrohen.

Në nenin 24 të Ligjit Nr. 10192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, nën titullin “**Pranimi i kërkesës për konfiskim**” parashikohet shprehimisht se: “1. **Gjykata vendos konfiskimin e pasurisë kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:**a) ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, për pjesëmarrje të personit në veprimtari kriminale, të parashikuara në nenin 3, pika 1, të këtij ligji; b) rezulton se pasuria është, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji; c) nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme apo personat e përmendur në nenin 3, të këtij ligji, nuk arrijnë të përlligjin zotërimin e pasurive ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre. 2. Në çdo rast, personi nuk mund të përlligjë pasurinë, duke deklaruar si burim të saj të ardhura ose riinvestime, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve. 3. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, gjykata vendos pranimin e kërkesës për

konfiskimin e pasurisë edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit të përmendur në pikën 1, të nenit 3, të këtij ligji, pushohet ose ai deklarohet i pafajshëm, me përjashtim të rasteve kur në vendimin e pushimit ose të pafajësisë deklarohet se: a) fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale.” Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se nëse ndaj një personi është pushuar çështja penale me motivacionin se fakti nuk ekziston nuk mund të iniciohet asnjë proces konfiskimi pasuror që standard i provueshmërisë shkon tek “indicia” dhe jo me të deklarohet fajtor për një vepër penale që standard i provueshmërisë është tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sikurse u theksuar më lartë **midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (condicio sine qua non).** Pra, nëse nuk kemi të konsumuar nga ana objektive një vepër penale mëmë nuk mund të filet për pastrim të produktit të saj, pasi produkti sipas nenit 287 të Kodit Penal, duhet të rrjedhë si rezultat i një fakti i cili parashikohet nga ligji si vepër penale. Prandaj, në çdo rast duhet që midis veprimeve të autorit të veprës penale që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së pasojës, pastrimi i produktit të veprës penale, duhet të ekzistojë lidhje shkakësore. **Në rastin konkret nuk ekziston ndonjë fakt penal që të gjenrojë të ardhura të paligjshme që të kemi më pas pastrim të tyre.**

Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron ardhjen e pasojës, pastrimin e produktit të veprës penale, pra ai ka dijeni se pasuria apo avantazhi ekonomik i ardhur nga vepra penale mëmë, përbën produkt të veprës penale dhe dëshiron që këtë produkt ta pastrojë përmes veprimeve aktive të realizuara në njërin nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal. Qëllimi është element cilësues i dispozitës konkrete dhe ai konsiston në: a) fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale. b) shmangia nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave. Pra, autori i veprës penale, veprimtarinë e tij kriminale e kryen duke e ditur që avantazhet apo pasuria që ai disponon janë produkt i veprës penale dhe synon t'i pastrojë ato, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm. Gjithashtu, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Prandaj, për të përcaktuar anën subjektive në çështjen objekt gjykimi, do të analizojë veprimet e të pandehurit. Dijenia dhe qëllimi, parashikohet në këtë nen, nxirren nga rrethana fakti objektive. Ky mund të jetë një nga elementët më të vështirë për t'u përcaktuar. Sigurisht, kur subjekti ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë në veprimtarinë kriminale që mund të provohet, atëherë dijenia e tij në lidhje me origjinën e fondeve është e dukshme. Gjithsesi, bashkëpunëtorët që ndihmojnë kriminelët për të përdorur, "sistemuar", strukturuar pasuritë e tyre shpesh pretendojnë dhe mbrohen se nuk e dinin se pasuria ishte produkt i veprës penale. Në rrethana të tilla, agjencitë ligjzbatuese duhet të mbështetet në provat rrethanore. Përshebull, prova se një afarist ka marrë sasi të mëdha parash cash nga një individ në rrethana të dyshimta; ose që personi që i ka dhënë paratë njihej ose kishte opinionin se ishte i përfshirë në veprimtari kriminale jashtë shtetit; ose se ka pasur një sërë transaksionesh të komplikuar të cilat janë pa kuptim për biznesin, mund të mbështesin

konkluzionin se i akuzuari për pastrim parash e dinte se paratë ishin produkt i një lloj veprimtarie kriminale. Në interpretim të nenit 287 të Kodit Penal, dijenia e subjektit për origjinën kriminale të produkteve të cilët përbëjnë objektin të veprës penale, nxirret jo vetëm nga provat direkte por edhe nga ato jo të drejtpërdrejta. Kështu, në plotësim të këtij elementi, çmuj se të pandehurit, nuk rezultojnë të kenë kryer ndonjë veprim të paligjshëm, pasi nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ekziston fakti i cili i atribuohet atyre nga prokuroria se kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. **Në këto kushte, përderisa nuk provohet se ekziston fakti penal për të cilin akuzohen të pandehurit, atëherë nuk provohet as faj, pasi nuk provohet si elementi intelektual ashtu dhe ai volutiv, që të ekzistojë faj si element thelbësor i përgjegjësisë penale.**

Gjatë gjykimi nuk provohet konsumimi i objektit, anës objektive dhe anës subjektive të veprës penale të parashikuara nga neni 287te K.Penal.

Në përfundim të analizës së mësipërme të fakteve dhe provave, gjykata arrinë ne konkluzionin se edhe pas kryerjes se veprimeve hetimore te lena detyre nga gjykata me vendimin nr. 240 akti date 15.12.2017, dhe ato te kryera ne dinamike nga ana e prokurorise, nuk arrihet te provohet pertej cdo dyshimi te arsyeshem ekzistenca e elementeve te veprës penale te “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal rrjedhimisht edhe te veprës penale të “Pastrimit të produkteve te veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe ne keto kushte ceshtja penale duhet te pushohet.

Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 329/b pika “2” të K.Pr.Penale nën titullin “**Shqyrtimi i kërkesës**”, ku parashikohet shprehimisht se: “3. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes.”, si dhe në nenin 328 pika 1 gërma “b” të K.Pr.Penale çmon se duhet vendosur Pushimi i procedimit penal nr. 7340, të vitit 2017, për veprën penale të “**Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm**”, parashikuar nga neni 245/1 I Kodit Penal rrjedhimisht edhe te veprës penale të “**Pastrimit të produkteve te veprës penale**”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 328, 329/a e 329/b të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI:

- 1) Pushimin e çështjes penale nr.7340, të vitit 2017, regjistruar sipas nenit 245/1 dhe 287, teKodit Penal.
- 2) Kunder vendimit mund te behet ankim brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga e nesermja e shpalljes ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall sot ne Tirane, me date **24.01.2020**.

SEKRETARE

GJYQTAR

ADELINA XHELILI

LAZER SALLAKU